ALBANIAN AIRLINES
Tel. 06-6501.1520
Roma Fiumicino

Bota Shqiptare

IL MONDO ALBANESE
Gazeta e shqiptarëve në Italì

VITI / ANNO IV NR. 65
4 - 17 KORRIK 2002
(4 - 17 LUGLIO 2002)

QUINDICINALE DEGLI ALBANESI IN ITALIA. Iscritto al Registro Stampa del Tribunale di Roma al nr. 213/99 del 12.05.99. Spedizione in abonamento postale 70% - Roma. Editore: Bota Shqiptare - Il Mondo Albanese Onlus, Roma. Direttore Responsabile Elio Ricchiuto. Direttore Roland Sejko. Redazione Viale Tito Livio 8, 00136 Roma; Tel/Fax 06-35453074. Cell. 339-3798796 redazione@botashqiptare.net. Stampa: Eurostampe srl, Roma. Distribuzione Nazionale Edicole: Intercontinental srl, Milano. Associato a USPI - UNIONE STAMPA PERIODICA ITALIANA

Euro 1,50

KUFIJ

Letra të ushtarëve italianë në Shqipëri



Faqe 8

BALLKAN

Satelitët spiunë të Natos transmetojnë... free

Faqe 7

SPEKTAKËL

Kapardisja e Valbona Çobës

Faqe 10

Marrëveshja Berisha-Nano dhe Presidenti në mes

Nga Violeta Kongo

Marrëveshja pozitë-opozitë e së dielës së shkuar për një president konsensual bëri që Parlamenti Shqiptar të votojë qetësisht Alfred Moisiun President të ri të vendit.

Si për habi të të gjithëve, pas një krize të gjatë brenda partisë në pushtet, të krijuar nga vetë kreu i kësaj partie, Fatos Nano, për të realizuar ambicien e tij drejt presidencës, Presidenti Moisiu, një ditë më pas, më 24 qershor, u zgjodh me 97 vota pro përballë asnjë altrnative tjetër.

Një seancë paralmentare duartrokitjesh kjo që të kujtonte votimet parlamentare të kohës së regjimit të Enver Hoxhës.

Brenda pak ditësh u fashitën akuzat, kundërakuzat pozitë-opozitë. Por edhe brenda kundërshtarëve të partisë në pushtet u kalua në flirte, u detyruan edhe të pabindurit e fundit të heshtin për hir të unitetit pozitë-opozitë. Opozita nuk po kërkon më zgjedhje të parakohshme, Dushkun nuk po e përmend më. Por edhe brenda PS-së nuk po përmendet as korrupsioni, papunësia dhe të gjitha krizat e tjera që kanë qenë objekt i një fushate të paparë të Nanos dhe që lanë vendin jashtë dyerve të Europës.

Është i dyshimtë fakti që kjo ujdi politikanësh të jetë bërë për hir të vendit. Historia e politikanëve shqiptarë të detyron të besosh se është bërë për interesa personale.

Në horizont po konfigurohet një qeveri e re, rezultat i aleancave konkrete mes dy kundërshtarëve që bënë çorap Partinë Socialiste, Fatos Nanos dhe Ilir Metës. Ka të ngjarë që qeveria "në projekt" të jetë rezultat edhe i aleancave "fluide" të shpikuara kohët e fundit, mes pozitës dhe opozitës.

Në këtë rast, nuk është fjala për të folur për Kryeministrin Majko që po keqpërdoret rëndshëm nga politikanët e PS-së, të etur për pushtet, por për të folur për një moral minimal të nevojshëm për politikën:

Nuk është asnjë shqiptar i ndershëm kundër marrëveshjeve që janë në të mirë të vendit, të tilla që do ta qytetëronin klasën politike shqiptare për të mos recituar keq jo vetëm në Bruksel por edhe para shqiptaërve, që tashmë i njohin me rrënjë e dhëmballë politikanët e tyre.

vijon në faqen 4

ISSN 1720-3678
00065
9 771720 367001

Alfred Moisiu, 74 vjeç, një ish-gjeneral ushtarak në pension, presidenti i ri i Shqipërisë

Qershori sjell Presidentin. Dhe Mbretin.

Më 97 vota pro Parlamenti shqiptar zgjedh që në votimin e parë Presidentin e ri të vendit. Pak ditë më pas në Rinas pritet "triumfalisht" i biri i mbretit Ahmet Zogu me gjithë oborrin e vet. Kthimi i qytetarit të mirë Lekë apo i aspirantit për mbret?

Alfred Moisiu, Presidenti i ri i Shqipërisë

1. Parlamenti Shqiptar, me 97 vota pro zgjodhi më 24 qershor në mbrëmje Alfred Moisiun si President të ri të vendit. Sipas Kushtetutës së Shqipërisë, për zgjedhjen e presidentit duheshin 84 vota. Në seancën e votimit morën pjesë 134 deputetë, të cilët votuan të gjithë. Nga këta, 19 votuan kundër, 14 abstenuan, ndërsa 4 fletë-votimi rezultuan të pavlefshme Alfred Moisiu ishte i vetmi kandidat i paraqitur në Parlament nga një grup prej 40 deputetësh të partive më të mëdha të Parlamentit, kryesisht të Partsë Socialiste që kontrollon pjesën më të madhe të vendeve në Parlament dhe Partisë Demokratike, partia më e madhe e opozitës.

2. Familja e ish-mbretit Ahmet Zogu u kthye përfundimisht në atdhe. "Dua të falenderoj popullin shqiptar, shtetin shqiptar që na dha këtë rast me u kthy në atdheun tonë," tha Leka Zogu në Rinas në një ceremoni pritjeje mjaft festive të organizuar nga përkrahësit e mbretit, dhe ku merrnin pjesë dhe autoritete shtetërore dhe përfaqësues të partive politike shqiptare.

Kthimi i Leka Zogut u mundësua pas një amnistie të shpallur këtë muaj për rolin e tij në trazirat gjatë referendumit për të ardhmen e monarkisë të mbajtur pesë vjet më parë. *në brendësi*

Leka Zogu, i biri i ish-mbretit Ahmet Zogu

Paraqiten të dhënat paraprake të Dossier Immigrazione

Itali 2002: 25 000 emigrantë më pak

faqe 3

Konferenca e Seviljes nuk adopton kërkesat e egra të Italisë

Europa zbut linjën e ashpër për emigrantët

faqe 3

Janë mëse dhjetëmijë shqiptarë, kinezë, egjiptianë

Sipërmarrësit emigrantë në Milano

faqe 2

AKUZA PËR "MBRETIN" VJEN NGA ÇATINI

"Unë, Çatin Saraçi, të akuzoj ty, Ahmet Zogu..."

Studiuesi Aurel Plasari nxjerr në dritë letrën e panjohur deri më sot të autorit të librit në dorëshkrim "Historia e një maskarai"

faqe 8-9

Kur kontrabandën e bën shteti: lidhjet e Enver Hoxhës me Cosa Nostra-n

Nga Enver Hoxha te Gjukanoviçi, rrugët e Marlboros kanë kaluar nëpër Shqipëri dhe Mal të Zi, për llogari të shtetit, me pëlqimin dhe nën kontrollin e tij. Si kanë funksionuar lidhjet me organizaten mafioze Cosa Nostra dhe pse asnjë ngarkesë nuk ra në duart e policisë italiane

Lajmi eshte nga ata qe bejne xhiron e botes: Nje kryetar shteti qe hetohet per lidhje me Mafian dhe organizimin e kondrabandes se cigareve. Sipas akuzes se DDA te Barit, Presidenti Milo Gjukanovic, kishte themeluar, organizuar dhe drejtuar se bashku me Sacra Corona Unita si dhe Camorra, nje trafik prej mijera tonelatash cigare nga Mali i Zi per ne brigjet pulieze. Duke pasur dijeni per gjendjen e shtetit federal te Malit te Zi, shume vezhgues e kane percaktuar si ne nje model te shtetit mafioz, ku kondrabanda e cigareve duket si nje e keqe e vogel, kundrejt trafiqeve me te fokusuar ne vemendje qe jane droga, armet, qeniet njerezore. Por kondrabanda e cigareve na kthen pas ne histori, na fton te refelektojme per marrdheniet e tregetise ilegale dhe tregut boteror dhe rizgjon kujtimet per 10-vjecarin qe sapo kaluam.

Faqe 6

Ilir Shaqiri: "Vallëzimi, poezi ku çdo lëvizje është fjalë"

Kush është balerini shqiptar i emisioneve më të famshme televizive të Mediasetit.
Ilir Shaqiri rrëfen për "Bota Shqiptare" rrugën e gjatë dhe të vështirë drejt suksesit, nga fillimi përkrah prindërve balerinë të Teatrit të Operas dhe Baletit shqiptar, deri tek turmat e fanseve që shkojnë në delir në Itali.

nga Julia HAMO

faqe 10-11